VENDIM
Nr. 91, datë 22.2.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "KRIJIM HAPËSIRE REKREATIVE NË ZONËN E LIQENIT ARTIFICIAL TË QYTETIT BALLSH, BASHKIA MALLAKASTËR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh, Bashkia Mallakastër".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Mallakastër.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 405 900 (katërqind e pesë mijë e nëntëqind) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 405 900 (katërqind e pesë mijë e nëntëqind) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (muajve) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Mallakastër.
8. Bashkia Mallakastër kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Mallakastër.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mallakastër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mallakastër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Mallakastër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "KRIJIM HAPËSIRE REKREATIVE NË ZONËN E LIQENIT ARTIFICIAL TË QYTETIT BALLSH, BASHKIA MALLAKASTËR"

									VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM				
	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE					TOKE ARË				
Nr.	**Emri**	**Atësia**	**Mbiemri**	**Fshat/ qytet**	**Nr. i pas.**	**ZK**	**Lloji i pasurisë**	**Sip. totale**	**Sip. e shpronësuar (m^2)**	**Çmimi (lek/ m^2)**	**Vlera (lek)**	**Vlera totale**	**Shënime**
1	Dashnor	Adem	Malasi	Ballsh	30/40	1090	Arë	1600	1600	123	196,800	196,800	Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mallakastër. Çmimi prej 123 lekësh/m^2 është sugjeruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 3720/1 prot., datë 15.7.2022, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 3520/1 prot., date 19.7.2022
2	Veledin	Adem	Malasi	Ballsh	30/42	1090	Arë	1700	1700	123	209,100	209,100	Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mallakastër. Çmimi prej 123 lekësh/m^2 është sugjeruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 3720/1 prot., datë 15.7.2022, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 3520/1 prot., date 19.7.2022
TOTALI												**405 900**	